



DEKLARATË PËR MEDIA

Centre for Legal Empowerment, në bazë të informacionit paraprak të përcjellë nëpërmjet deklaratës për shtyp të datës 02.05.2023 nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë si dhe në bazë të komunikimeve të saj me familjarët e shtetasit J.R shpreh shqetësimin dhe kërkon hetim të menjëhershëm të rrethanave.

Nga deklarata për shtyp e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë mësohet se:

- Shtetasi J. R. për shkak të emergjencës shëndetësore është transportuar në spitalin "Nënë Tereza", ku dhe është shtruar në ambientet e spitalit në datën 17.04.2023;
- Autoritetet e IEVP 313, nuk kanë pranuar që ta marrin në dorëzim për shkak të mbingarkesës në këtë institucion dhe në këto kushte ai është rikthyer dhe vendosur përsëri në Bllokun e Sigurisë Tiranë;
- Shkaku i emergjencës shëndetësore dhe shtrimit në ambientet e spitalit të paraburgosurit J. R. rezulton ende i paqartë.

Ndërkohë nga komunikimi me familjarët e shtetasit J.R rezulton se:

- Znj. P. R. (nëna e J. R.) është njoftuar për gjendjen shëndetësore të djalit në datën 28.04.2023, pra 11 ditë më vonë, ndërkohë që ligji parashikon se në rastet e dëmtimeve serioze të paraburgosurit, IEVP-ja, njofton menjëherë familjarët ose të afërmit e të paraburgosurit.
- Nuk kanë asnjë informacion në lidhje me arsyet dhe shkaqet e gjendjes së rëndë shëndetësore të djalit;

Centre for Legal Empowerment, referuar informacioneve të mësipërme shpreh shqetësimin dhe kërkon hetim të menjëhershëm dhe të plotë të rrethanave duke ngritur këto pyetje:

1. Cili është shkaku i gjendjes së rëndë shëndetësore të shtetasit J. R.?
2. A i është nënshtruar shtetasi J.R një vizite ekzaminuese dhe interviste mjekësore nga ana e mjekut në momentin e pranimit në institucionin e paraburgimit?
3. Cila ka qenë shkaku që Znj. P. R. (nëna e J. R.) është njoftuar mbas 11 ditësh për gjendjen e rëndë shëndetësore të djalit të saj dhe faktit që ai ka qenë shtruar në ambientet e spitalit?
4. Cila është arsyeja që familjarët e shtetasit J.R nuk janë informuar ende për shkahun e gjendjes së rëndë shëndetësore të tij edhe mbasi kanë kaluar 15-të ditë nga emergjenca shëndetësore dhe shtrimi në ambientet e spitalit?



DEKLARATË PËR MEDIA

Avokatët e Centre for Legal Empowerment, në cilësinë e përfaqësuesve ligjor të zonjës P. R. (nëna e shtetasit J. R.), kanë paraqitur pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Spitalit Universitar Nënë Tereza Tiranë kërkesat për vendosjen në dispozicion të informacionit dhe dokumentacionit për verifikimin e rrethanave të sipërcituara.

Centre for Legal Empowerment është në pritje të një përgjigje të shpejtë dhe pozitive nga ana e institucioneve të sipërcituara, në mënyrë që të zhvillojë një hetim të menjëhershëm, të plotë dhe të gjithanshëm të shkaqeve dhe rrethanave që kanë shkaktuar dëmtimin dhe gjendjen e rëndë shëndetësore të shtetasit J.R gjatë qëndrimit në paraburgim.